

VENDIM
Nr. 302, datë 17.11.2025
MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPITALLA SOLAR” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
(Ndryshuar me vendimin nr. 77, datë 12.3.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 17.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2403/12 prot., datë 13.11.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Spitalla Solar’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, konstatoi se:

- Shoqëria “Spitalla Solar” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2403 prot., datë 4.9.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 215, datë 18.9.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 19.9.2025 dhe 20.9.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 20.10.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE po ashtu ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 2403/6 prot., datë 25.9.2025, si dhe i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Me shkresën nr. 2403/7 prot., datë 25.9.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën e protokolluara në ERE me nr. 2403/8 prot., datë 14.10.2025, shoqëria ka depozituar një argumentim teknik, në lidhje me kapacitetin e instaluar të centralit, ku sqaron se fuqia e rumbullakosur sipas sistemit DC është 100 mw (DC) ose 90 mw (AC). Për sa argumentuar nga shoqëria dhe duke qenë se ERE jep licencë për kapacitetin e instaluar të shprehur në mw, licenca e shoqërisë do të jetë për kapacitetin total të instaluar 90 mw.

- Po ashtu, me shkresën e sipërcituar, shoqëria ka depozituar një pjesë të informacionit/dokumentacionit plotësues, nga shqyrtimi i të cilit është parë e nevojshme zhvillimi i një seance dëgjimore për arsye të sqarimit të mëtejshëm të dokumentacionit të munguar. Ndaj ERE, me shkresën nr. 2403/10 prot., datë 27.10.2025, i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar zhvillimin e seancës dëgjimore.

- Pas sqarimeve të dhëna në seancën e datës 3.11.2025, nga ana e përfaqësuesve të shoqërisë u mor angazhimi për të depozituar në ERE informacionin/dokumentacionin e konstatuar të munguar.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2403/11 prot., datë 10.11.2025, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE: “Marrëveshjen për zhvillimin e projektit, në lidhje me projektimin, financimin, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e impiantit fotovoltaiik me vendndodhje në Spitallë, Durrës, Shqipëri”, më datë 31.5.2021.

- Akt marrëveshjen “Marrëveshje përfundimtare në lidhje me marrëveshjen për zhvillimin e projektit për ndërtimin financimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e një impianti fotovoltaiik me vendndodhje në zonën e Spitallës, Durrës, Shqipëri”, datë 20.12.2024.

- Me shkresat e “OST” sh.a., nr. 1512/4 prot., datë 17.6.2025 dhe nr. 1512/8 prot., datë 13.10.2025, ka marrë miratimin në parim të pikës së lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit.

- Shoqëria është pajisur me deklaratën mjedisore, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 28.10.2025.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka deklaruar se jetëgjatësia e pritshme e centralit është 30 vite, ashtu sikurse nga plani i biznesit rezulton se jetëgjatësia ekonomike është 30 vite, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e transmetimit, rezulton se shoqëria është brenda afatit të përcaktuar në miratimin në parim të dhënë nga “OST” sh.a. nëpërmjet shkresës së datës 17.6.2025, dhe ka dokumentuar që ka pranuar ofertën.

- Duke qenë se nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar apo nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaiik, duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaiik, lidhja e tij me rrjetin elektrik është e garantuar, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me “OST” sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 28.10.2027, dhe duke marrë në konsideratë faktin se vetë shoqëria ka parashikuar që të vendosë në operim centralin brenda muajit dhjetor 2027, vlerësohet që t’i lihet asaj kusht që të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.12.2027.

- Në referencë të sa parashikuar në pikën 6.8 të marrëveshjes së zhvillimit të nënshkruar me MIE-n, në lidhje me procedurën e kolaudimit të veprës, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, por jo me vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës, si dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 90 mw, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shfuqizuar.*

3. Shoqëria “Spitalla Solar” sh.p.k. duhet të fillojë operimin e centralit brenda datës 31.12.2027.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE kolaudimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

5. *Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.*

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti